

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN LENIE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Lenie me objekt: “vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimeve me fonde publike, taksave e tarifave vendore, administrimit të asetëve, funksionimit të policisë komunale, etj” për periudhën 01.01.2010-31.12.2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 111, datë 30.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 453/8, datë 30.06.2012, dërguar z. **Astrit BICI**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Këshilli i Komunës Lenie dhe Kryetari i saj, të marrin në analizë rezultatet e auditimit të KLSH-së, të nxjerrin përgjegjësitë dhe të hartojnë programin për realizimin e rekomandimeve, në zbatim të ligjit 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar.

Menjëherë

2. Komuna Lenie, të hartoj planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat, të hartojë plan veprimet afatshkurta, duke i implementuar gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të buxhetit vendor, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

3. Të merren masa për të hartuar dhe miratuar strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe sektorial, të ngrihen ekipet përkatëse të menaxhimit, të hartohet lista e proceseve dhe gjurmëve të auditimit, lista e menaxhimit të strategjisë së riskut, të cilat të merren në konsideratë për hartimin e projekt buxhetit të vitit 2013, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

4. Të merren masa nga Zyra e Financës, për vlerësimin e njëjtë të buxhetit vendor dhe atij qendror, duke siguruar evidentim të saktë si gjatë procesit të hartimit, ashtu dhe gjatë procesit të menaxhimit në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Vazhdimisht

5. Nga Komuna Lenie të merren masa, të hartohen dhe zbatohen strategjitë dhe objektivat, në përmirësimin e sistemit të ndihmës ekonomike për uljen e varfërisë, duke përdorur punët komunitare, dhe kryesisht në mbarështimin dhe menaxhimin e resurseve pyjore, kullosore, florës, faunës, etj, sipas programeve përkatëse të menaxhimit në zbatim të VKM nr. 787, datë 14.12.2005.

Vazhdimisht

6. Komuna Lenie, të rishikojë marrëveshjen ekzistuese datë 01.4.2011 “Mbi shpërndarjen e pagesave të ndihmës ekonomike dhe të personave me aftësi të kufizuar” të lidhur me Postën Shqiptare Filiali Elbasan. Të përfshijë në këtë marrëveshje rregullimet e pikës 3 që lidhet me të drejtat e palës komunë për administrimin e listë pagesave, rakordimin mujor të pagesave të kryera dhe kthimin e shumave të ndihmës ekonomike të pashpërndara, në zbatim të VKM nr.

787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike”, si dhe në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

7. Zyra e Ndihmës Ekonomike të hartoj regjistrin e të dhënave analitike të çdo banori të komunës, dhe të bashkërendojë punën me Drejtorinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, për marrjen e të dhënave lidhur me kategorinë dhe bonitetin e tokës bujqësore, në zbatim të udhëzimit nr. 338/3, datë 10.3.2006 “Mbi zbatimin e VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

Menjëherë

8. Komuna Lenie të vendos administrimin, dokumentimin lëvizjen dhe qarkullimin dhe vlerësimin si letra me vlerë të biletave që përdoren për shërbime të komunës në drejtim të shërbimit të turizmit malor, sportiv etj. Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik”.

Menjëherë

9. Zyra e Tatim Taksave të hapë dhe plotësojë me të dhënat regjistrin e taksave vendore për vitin 2010-2011, e në vazhdim, të plotësojë kartelat e taksave dhe tarifave vendore sipas të dhënave të vendndodhjes, numrit të identifikimit, llojit të aktivitetit etj, me qëllim evidentimin dhe ndjekjen e realizimit në zbatim të UMF nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

10. Nga ana e Komunës Lenie të merren masa për rekrutimin e punonjësve të administratës me synimin e përputhjes së pozicionit të punës me nivelin arsimor e profesional sipas strukturës dhe të hartohen e lidhen kontratat e punës, si dhe të plotësohen dosjet përkatëse të punonjësve, në zbatim të VKM nr. 355, datë 7.7.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit”.

Menjëherë

11. Nga ana e Komunës Lenie të parashikohen në buxhetin e vitit 2013, fondet për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, fonde për kryerjen e investimeve në IT me synim vënien në mbrojtje ligjore të pasurive, përdorimin me efektivitet të informacionit financiar dhe mbajtjes së kontabilitetit, ditarëve, regjistrimeve të aktiveve dhe të detyrimeve në mënyrë elektronike në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Menjëherë

12. Të mblidhen të ardhurat nga tatim taksat e prapambetura për të dy vitet përkatësisht **323** debitor me vlerën **339,671 lekë**, si dhe të llogariten gjobat e kamatë vonesat, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Menjëherë

13. Nga komuna Lenie, të kryhet inventarizimi fizik dhe të kontabilizohen vlerat materiale e pasurore, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Deri në Tetor 2012

14. Nga komuna Lenie, të merren në administrim, inventarizohen, regjistrohen në ZVRPP Gramsh 83 pasuritë e transferuara dhe të vihen në efencë, duke hartuar plane të reja dhe zbatuar planet ekzistuese të menaxhimit, për sipërfaqet pyje e kullota gjendje, gjithashtu dhe për 1940.7 ha, të transferuara, në zbatim të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, ligjit nr. 8743, datë

22.2.2001 dhe VKM nr. 286, datë 12.03.2008, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Të kryhet menjëherë rivlerësimi dhe regjistrimi i vlerës së kontabilizuar të objekteve ndërtimore të komunës, në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001.

Menjëherë

15. Zyra e Financës të Komunës Lenie, të çel ditarin e veprimeve të ndryshme, regjistroj të gjitha veprimet ekonomike të lidhura me shtesat dhe pakësimet e AQT si dhe të pasqyrohen në inventarin pasuror, në librin përkatës të aktiveve dhe në bilancin financiar.

Menjëherë

16. Nga ana e Komunës Lenie pasi të analizohet aktiviteti i Policisë së Komunës, të marrë masat e menjëhershme për vënien në efikasitet të plotë të strukturës së policisë së komunës, dhe për shmangien e mosngarkimit me detyra të tjera jashtë funksionit ligjor të saj, të vendos marrëdhëniet e bashkëpunimit me strukturat e tjera të policisë së Shtetit, policisë pyjore etj, në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për policinë bashkiake të komunës”.

Menjëherë

17. Komuna Lenie të lidhë marrëveshjen me Këshillin e Qarkut Elbasan, për delegimin e kompetencave të Inspektoratit Ndërtimore e Urbanistik, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

Menjëherë

18. Komuna Lenie të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve nr. 3044/3, datë 30.11.2011, të auditimit të Prefektit, për ekzekutimin kontabilizimin dhe vjeljen e detyrimeve të prapambetura në vlerën **323,700 lekë**, përkatësisht **136,850 lekë** ndaj z. ■■■ dhe **186,850 lekë** ndaj z. ■■■ në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, të ndryshuar, me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Komuna Lenie të kontabilizojë dhe të filloj procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik si shpenzime për udhëtim e dieta në shumën **684,400 lekë**, ndaj personave përcaktuar në tabelën nr. 12/1-12/19, dëmit ekonomik në shumën **176,639 lekë**, ndaj personave përcaktuar në tabelën nr. 13 dhe nr. 14, si shpenzime për pritje e përcjellje, dëmit ekonomik në shumën **79,814 lekë**, shpenzime për telefoninë celulare dhe dëmit ekonomik në shumën **104,760 lekë**, shpenzimet për shpërblimin e këshilltarëve, ndaj personit përcaktuar në tabelën nr. 15, në zbatim të VKM nr. 1198, datë 3.12.2009, VKM nr. 258, datë 3.6.1999 dhe VKM nr. 864, datë 23.7.2010.

Menjëherë

2. Komuna Lenie të kontabilizojë dhe të fillojnë procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën **260,860 lekë**, ndaj subjektit fizik ■■■, për shumën **138,570 lekë**, për punime të pakryera, ndaj subjektit fizik ■■■, në shumën **110,290 lekë**, përfituar tepër në punimet e objektit “Mirëmbajtje rruge Lenie-Liqeni i Zi”, dhe dëmit ekonomik në shumën **12,000 lekë**, ndaj komisionit të prokurimit për shkeljen e procedurave në blerjen e blloqeve të betonit, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 dhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

Menjëherë

3. Komuna Lenie të marrë masa dhe zbatoj menjëherë UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pa ndara”, lidhur me dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore në sipërfaqen 106,035 ha, me afat 99 vjet, dhe të arkëtojë vlerën prej

45,522 lekë qira e kamat vonesa, të pa arkëtuara përkatësisht ndaj subjektit ■■■ 39,908 lekë dhe ■■■ 5,614 lekë, në zbatim të ligjit nr. 8318, datë 26.03.1998.

Menjëherë

4. Komuna Lenie të kontabilizojë dhe të fillojnë procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në shumën **36,000 lekë**, ndaj z. ■■■, për shkelje në dokumentim të materialeve zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Menjëherë

5. Komuna Lenie të kontabilizojë dhe të fillojnë procedurat ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik të shkaktuar nga keqadministrimi i listë pagesave të ndihmës ekonomike në shumën **19,980 lekë**, përkatësisht ndaj z. ■■■ për shumën **5,915 lekë**, z. ■■■ për shumën **2,875 lekë**, dhe ndaj z. ■■■, punonjësi Filialit të Postës Elasan për shumën **11,190 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, dhe me VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në neni 42, germa “a”, nenin në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, dhe në 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshime, ti kërkohet Zotit Kryeministër të marrë masën disiplinore:

1. “Shkarkim nga detyra” për:

z. ■■■ me detyrë Kryetar Komune, për shkeljet ligjore të mëposhtme:

- Në ushtrimin e kompetencave në **cilësinë e kryetarit të Komunës**, për vitin 2010 dhe 2011:
- Në kundërshtim me germën “a” dhe “g” të nenit 44, të ligjit nr. 8652 datë 31.7.2000, nga Kryetari i Komunës Lenie nuk është drejtuar dhe organizuar puna për hartimin e planit për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe planin strategjik të veprimit afatshkurtër, nuk ka përcaktuar objektivat e komunës, ka munguar formulimi, implementimi dhe monitorimi i vlerave të njësisë dhe kodit të etikës, mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve, miratimi i politikave të nivelit të lartë dhe të strukturës organizative.
- Gjithashtu mungojnë plani strategjik i kësaj komune dhe plan veprimet afatshkurtër, si dhe përcaktimi i objektivave, ndonëse pasuritë në zotërim të kësaj komune janë të mjaftueshme për një zhvillim progresiv. Ka munguar kontrolli i brendshëm, strategjitë e tij dhe ngritja e strukturave përkatëse, për ushtrimin dhe menaxhimin e riskut, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Nuk ka përgatitur projektbuxhetet për vitin 2010 dhe 2011, raportet e kërkesave për shpenzime me formularët përkatës nr. 1 dhe nr. 2. Mungojnë strategjia e zhvillimit të kësaj komune dhe strategjitë sektoriale, si dhe nga ana e Kryetarit nuk janë ngritur ekipet përkatëse të menaxhimit, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
- Ka lejuar mungesa evidentimi në zbatimin e buxhetit, ndjekjen dhe realizimin në nivele të ulët deri në 90 %, ka lejuar njëanshmëri të ndjekjes së buxhetit qendror me nënvleftësim të pjesës të buxhetit vendor si në hartim dhe në zbatim, në kundërshtim me ligjin nr. 10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”.
- Ka lejuar mungesën e strategjive me objektiv përmirësimin e sistemit të programeve të ndihmës ekonomike, për uljen e varfërisë, nëpërmjet rritjes së efektivitetit të përdorimit të punëve

komunitare, ndonëse buxheti i ndihmës ekonomike për 168 familje në secilin vit 2010-2011 ka qenë në shumën **12,061,700 lekë** dhe **12 337 870 lekë**, d.m.th. sa dy herë më shumë se buxheti vjetor i komunës, në kundërshtim me VKM nr. 787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike” dhe udhëzimet përkatëse.

- Ka lejuar dhe ndërtuar strukturën administrative dhe ka emëruar punonjës në mospërputhje ndërmjet pozicionit të punës dhe nivelit arsimor. Gjithashtu e ka bërë rekrutimin e punonjësve pa kontrata pune, pa dosjet përkatëse të punonjësve në kundërshtim me VKM nr. 355, date 7.7.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrit të personelit”.

- Ka lejuar parregullsi mangësi e shkelje në organizimin dhe mbajtjen e evidencës kontabël duke mos investuar në IT, për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, lejuar që llogaria dhe kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale. Mungojnë dhe nuk janë mbajtur librat si ditari i veprimeve të ndryshme e librave të tjerë, ka parregullsi në mbajtjen e ditarit të bankës dhe administrimin e urdhër shpenzimeve që kanë sjellë si pasoj mungesën e regjistrimeve lidhur me dokumentimin, lëvizjen e aktiveve, pasurive dhe pasqyrimin e detyrimeve debitorë, mosndjekjen e limitit të shpenzimeve dhe të buxhetit në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe aktet nënligjore.

- Ka patur mungesë në planifikimin zbatimin, dhe keqadministrim të shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve, ku me urdhrat e dërgimit me shërbim të punonjësve është shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Komunës në shumën totale **684,400 lekë**, nga e cila **439,400 lekë** në vitin 2010 dhe **245,000 lekë** në vitin 2011, në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr. 1198 “Për dietat e nepunësve, që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, të ndryshuar.

- Me urdhrat e Kryetarit gjithashtu, Komunës gjatë dy viteve i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **176,639 lekë**, si shpenzim për darka e shpërndarje pakosh për personelin, duke i evidentuar parregullsitë si shpenzime për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u behet delegacioneve të huaja, në kundërshtim me VKM nr. 258, datë 3.6.1999 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u behet delegacioneve të huaja”.

- Nga Kryetari i Komunës janë përfituar tepër kuotës së shpenzimeve të telefonisë celulare shuma prej **79,814 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik, përkatësisht **1,638 lekë** në vitin 2010 dhe **78,176 lekë** për vitin 2011, në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 343, datë 11.7.2002 dhe me pikën 1 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010.

- Është lejuar shkaktimi i dëmit ekonomik në shumën **104,760 lekë**, përkatësisht **56,160 lekë** në vitin 2010 dhe **48,600 lekë** në vitin 2011, si shpërblim i dhënë njëkohësisht për të dy funksione për kryetarin e këshillit të komunës z. ■■■ (xhaxhai i kryetari), në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

- Për secilin prej dy viteve ka munguar programi vjetor i kryerjes së inventarizimit fizik të pasurisë, ka lejuar kryerjen e pjesshme të inventarizimit fizik, duke mos inventarizuar aktivet e tjera si: ndërtesa, troje, pasuritë pyjore etj. Komisionet e inventarizimit të ngritura prej tij, kanë qenë të njëjtë, në përbërje me konflikt interesi, dhe me dokumentacion të parregullt të fletë inventarizimeve dhe të nxjerrjes jashtë përdorimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010.

- Nuk është bërë inventarizimi, e marrja në administrim, nuk janë zbatuar planet ekzistuese të menaxhimit dhe nuk janë hartuar plane të reja për menaxhimin e sipërfaqeve pyje-kullota gjendje dhe për sipërfaqen prej 1940.7 ha të transferuara, në kundërshtim me VKM nr. 286, datë 12.3.2008, dhe për monumentet e natyrës të përfshira në juridiksionin e komunës sipas VKM nr. 676, datë 20.12.2002. Gjithashtu, nuk është kryer regjistrimi i 83 pasurive të transferuara dhe nuk janë parashikuar fondet përkatëse për aplikimin në ZVRPP Gramsh, në kundërshtim me

ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" të ndryshuar, dhe ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, i ndryshuar "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit" dhe ligjin nr. 9385, datë 14.4.2005 "Për shërbimin pyjor", të ndryshuar.

- Nuk janë përfshira në librin e inventarit kontabël të AQT-ve aktivet si toka, troje, terrene të sipërfaqeve të objekteve arsimore, social-kulturore, administrative, rrugëve, shesheve, veprat kullosore, lerat, veprat ujore etj. që ka sjellë si pasojë mosevidentim të saktë e mosmenaxhim të pasurive e resurseve të komunës.

- Në cilësinë e kryetarit të entit prokurues ka lejuar që për secilin vit, komuna të mos hartojë regjistrin e parashikimeve dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve; përbërja e komisionit të prokurimeve të vogla ka qenë e njëjtë për secilin vit. Janë përdorur procedura të blerjeve të vogla, në shmangie të procedurave të tenderimit për shpenzimet në vlerën totale prej 1,888,381 lekë, nga e cila 1,450,953 lekë për investime në rrugë e ujësjellës, dhe 437 428 lekë për punime mirëmbajtje rrugë e ura, pra punime të njëjta e të ngjashme, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

- Në 12 raste përllogaritja e fondit limit prej **1,450,953 lekë** dhe preventivat janë hartuar nga specialistë pa licencë, pa projekte e skica dhe në 2 raste për fondin limit prej **439,970 lekë**, nuk ka preventiva, projekte e skica të miratuara. Shkeljet e procedurave dhe mangësitë në dokumentacion si akt kolaudimet, akt kontrollit, kanë sjellë mos pasqyrimin e gjendjes së aktiveve në ditarin e veprimeve të ndryshme dhe në kontabilitet, mangësi në administrimin e vlerave materiale dhe vështirësi në procesin e inventarizimit, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1999 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

- Zbatimi i punimeve të ndërtimit ka rezultuar me dëm ekonomik në shumën prej **296,860 lekë**, në 3 objekte, përkatësisht në objektin "Rikonstruksione të rrugëve në lagjen Senaj", në shumën **138,570 lekë**, për punime të pakryera, në objektin "Mirëmbajtje rruge "Lenie-Liqen Zi" në shumën **110,290 lekë**, dhe në objektin "Mirëmbajtje vepra ujore" në shumën **12,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe nga dokumentimi i parregullt i hyrje daljeve të materialeve të ndërtimit rezulton një dëm ekonomik prej **36,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

- Ka lejuar keqadministrim të biletave të zonës turistike, planifikim dhe parashikim të të ardhurave nga tatim taksat me rezerva, nën mundësitë reale, dhe duke raportuar me tejkallim të lartë, deri në nivelin 162.5%. Për pasojë nuk janë regjistruar e kontabilizuar 323 debitor për tatime taksa me vlerën **339,671 lekë**, nga të cilët 294 persona me vlerën **167,891 lekë** në vitin 2010 dhe 298 persona me vlerën **171,685 lekë** në vitin 2011, si dhe nuk janë llogaritur gjobot e kamatë vonesat, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

- Nga Kryetari i Komunës nuk është zbatuar UKM nr. 3, datë 16.5.2007 "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pa ndara", në dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore në 8 raste në sipërfaqen prej 106.035 ha, me nivel qiraje 600-610 lekë/ha, në vlerën vjetore **122,166 lekë**, me afat 99 vjet, si dhe nuk është arkëtuar vlera prej **45,522 lekë**, qira dhe kamat vonesa e tokës bujqësore në shumën **39,908 lekë** dhe **5,614 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", ligjin nr. 8318, datë 26.3.1998 "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore".

- Kryetari i Komunës në cilësinë e kryetarit të bordit për dhënie me qira të tokës bujqësore trajtuar më sipër, gjatë procedurës nuk ka ruajtur përparësitë sipas rendit për familjet bujqësore ose individët, që i kanë refuzuar tokat bujqësore; për familjet që nuk janë plotësuar me normë të plotë për fryme; për familjet që kanë marrë tokë bujqësore 1/2 e normës për frymë; si dhe familjet që përfitojnë sipas ligjit nr. 7514, date 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politike” që janë subjekt i ligjit “Për tokën”, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 531, date 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.

- Nuk ka funksionuar struktura e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik, pasi nga Kryetari i Komunës nuk është lidhur aktmarrëveshje, ndërmjet Komunës Lenie dhe Këshillit të Qarkut Elbasan, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”.

- Ka lejuar shkelje të kriterëve dhe procedurave të rekrutimit lidhur me krijimin, dhe organizimin e Policisë së Komunës, mungesë funksionimi dhe efektiviteti i veprimtarisë së kësaj strukture lidhur me evidentimin, raportimin, dhe bashkëpunimin me strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe angazhimi i policit me detyrën e shoferit të kryetarit komunës, në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për policinë bashkiake e të komunës”, të ndryshuar.

- Nuk ka zbatuar rekomandimet e auditimit të Prefektit nr. 3044/3, datë 30.11.2011, dhe nuk ka ekzekutuar detyrimet e prapambetura në vlerën 323,700 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, të ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Në ushtrimin e detyrës së Kryetarit të komunës, z. ■■■, nuk ka reaguar me shkrim në formën ligjore për të prezantuar konfliktin e interesit ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Kryetarit të Këshillit të Komunës përkatësisht z. ■■■ dhe z. ■■■, të cilët janë me lidhje nip e xhaxha pasi sipas pretendimeve të tij verbale shprehet se ky konflikt, nuk është mbajtur parasysht si nga Këshilli i Komunës ashtu dhe nga Prefektura e Qarkut Elbasan, e cila siç pretendohet me shkresë është shprehur për mungesë konflikti interesi (shkresë e cila nuk u paraqit, me gjithë kërkesën e audituesve), në kundërshtim me nenin 4, 5 germa “dh” dhe neni 6 pika 2 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

2. Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, ndryshuar me ligjin nr. 8085, date 13.3.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

“Largim nga puna” për:

1. z. ■■■ me detyrë përgjegjës i Zyrës së Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë;

- Për moszbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, lidhur me hartimin dhe zbatimin e planit strategjik dhe planet afat shkurtra, si dhe zbatimin e planit financiar dhe të kontrollit të brendshëm dhe mos menaxhimin e riskut.

- Për moszbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010” i ndryshuar; ligjin nr. 10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” dhe udhëzimet përkatëse lidhur me mos hartimin e projekt buxheteve (mos përgatitjen e formularëve nr. 1 dhe nr. 2 të viti 2010-2011, si dhe lidhur me mangësitë në zbatimin e buxheteve të secilit vit).

- Për shkeljet dhe mangësitë në zbatimin e ligjit nr. 9228, datë 24.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, lidhur me veprimet me bankën mbajtjen e ditarëve, bilancit, inventarizimin e pasurive, administrimin e shpenzimeve etj.

- Me cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla, për mangësitë dhe shkeljet lidhur me zbatimin e ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me prokurimet me shpenzimet për shërbime, mirëmbajtje, investime, mallra etj.

“Vërejtje me paralajmërim për Largim nga puna” për:

1. ■ me detyrë Sekretar i Këshillit të Komunës, përgjegjës i Zyrës Juridike dhe magazinier.
2. ■ me detyrë arkëtar, specialist finance dhe përgjegjës për shërbimin veterinar.
3. ■ me detyrë përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve, protokoll-arkiv dhe Personelit.
4. ■ me detyrë përgjegjës i Zyrës së Mbrojtjes së Tokës dhe Kadastrës dhe administrator shoqëror.
5. ■ me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës dhe specialist i Zyrës së Tatim Taksave dhe Tregtisë.
6. ■ me detyrë ish-polic i komunës dhe ish-shofer i kryetarit të komunës, aktualisht shofer i mjetit të transportit të komunës.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 248 “Shpërdorim detyre” të bëhet kallëzim penal për:

1. **Z. ■, me detyrë ish Kryetar i Komunës Lenie**, për periudhën e audituar, pasi gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mospërbushje të parregullt të detyrës, gjë që ka sjellë përfitime materiale dhe jo materiale të padrejta për personat e tjerë, në dëm të interesave publike.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selfo Zeneli, Qemal Shehu, Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT
